



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 32, pika 32.1, shkronja **b** të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.6.2008, merr

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE PËR SANIMIN E PASOJAVE TË VERSHIMEVE NË
LAGJEN "KODRA E TRIMAVE" DHE FSHATIN SHKABAJ

Neni 1

Të ndahen 230.000 € për ndihmë familjeve të cilat pësuan nga vërshimet në komunën e Prishtinës.

Neni 2

Grupit të parë, prej 23 familjeve -19 në lagjen "Kodra e Trimave" dhe 4 në fshatin Shkabaj, sipas Vendimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, iu ndahen ndihma të menjëhershme në shumën prej 1000 € për secilën familje, të cilat iu transferohen në xhirrollogaritë e tyre.

Neni 3

Shuma e mbetur prej 207. 000 € ndahet ndërmjet grupit të parë, prej 23 familjeve, të cilat, sipas vlerësimeve të Komisionit, u janë dëmtuar tërësisht objektet e banimit dhe grupit të dytë, prej 14 familjeve, të cilave u janë dëmtuar pjesërisht objektet e banimit. Relacioni ndërmjet grupit të parë dhe grupit të dytë do të përcaktohet në bazë të vlerësimit të Komisionit.

Neni 4

Familjeve të kategorizuara në grupin e parë do t'u ndërtohen objekte banimi me nga dy dhoma, një kuzhinë dhe një tualet, deri në nivelin e punëve të vrazhda ose do t'u aftësohen për banim shtëpitë përkatëse në nivelin e kostos që vlen për ata, që do t'u ndërtohen objektet. Gjatë ndërtimit të objekteve do të lirohet hapësira e përroit, si dhe hapësirat eventuale komunale të uzurpuara.

Neni 5

Familjet e kategorizuara në grupin e dytë do të ndihmohen me materialet e nevojshme për sanimin e pasojave nga dëmtimet e objekteve të banimit.

Neni 6

Për ndërtimin dhe sanimin e objekteve do të shpallet tender publik.

Neni 7

Publiku do të njoftohet për familjet përfituese nga grupi i parë dhe i dytë.

Neni 8

Monitorimin e ndihmave të përfituesve do ta bëjë Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale përmes një komisioni të veçantë.

Neni 9

Komuna do të kërkojë ndihma shtesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nga donatorët dhe bizneset për përkujdesjen e mëtutjeshme të grupit të parë, të dytë dhe të tretë.

Neni 10

Vendimin e realizon Kryetari i Komunës dhe Këshilli i Drejtorëve.

Neni 11

Mjetet si në nenin I të këtij Vendimi, ndahen nga të hyrat vetanake të buxhetit të Komunës.

Neni 12

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01 Nr. 400-864, më 25.6.2008

KRYETARI I KOMUNËS

Prof. dr. Isa Mustafa